



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 754/1 Prot

Tiranë më 22.02.2018

VENDIM

Nr.5, datë 22.02. 2018

***“Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”
në “Menaxhim Risku””***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 75, pika 3, gërma “a”; Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, Kreu I, pikat 1 dhe 2; Kreu II, pika 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 1; neni 20; si dhe në propozimin e Fakultetit të Ekonomisë me shkresat nr.1789 prot., datë 14.11.2017 dhe nr.251 prot., datë 13.02.2018, Senati Akademik i UT-ës në mbledhjen e dates 22.02.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Ekonomisë për hapjen programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Menaxhim Risku”.
2. Të përcillet në Ministrinë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë propozimi dhe dokumentacioni i plotë, për vijimin e procedurave miratuese për këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

PROF.DR. MYNYR KONI